



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 15.07.2024

Nr: 82

Ora:

VENDIM

PËR

**EMËRIMIN E AUDITIT TEKNICIENË PËR MBIKËQYRJEN E PROCESIT TË
HARTIMIT TË LISTAVE TË ZGJEDHËSVE, PËR ZGJEDHJET PËR KRYETAR TË
BASHKISË HIMARË, QARKU VLORË**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, nenit 61, pikat 2 e 3, të ligjit, nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, udhëzimit nr. 2, datë 28.12.2012, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, “Për miratimin e rregullave të veçanta për kushtet e kontratës dhe kryerjen e auditimit nga auditët teknicienë për verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave RKGjC”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S I N:

1. Emërimin e z. Laert Kraja audit teknicien për mbikëqyrjen e hartimit të listës së zgjedhësve, për zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Himarë, Qarku Vlorë.
2. Masa e shpërblimit për auditin teknicien është 91.000 (nëntëdhjetë e një mijë) lekë për periudhën nga momenti i emërimit deri në dorëzimin e raportit përfundimtar.
3. Ngarkohet auditi teknicien të propozojë ndihmësin përkatës, brenda 2 (dy) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 24 orëve nga shpallja e tij.

Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Lealba PELINKU

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 15.07.2024 Nr: 82
Ora:



“Për emërimin e auditit teknicienë për mbikëqyrjen e procesit të hartimit të listave të zgjedhësve, për zgjedhjet për kryetar të bashkisë Himarë, qarku Vlorë”